



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 22, datë 17.12.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“KOMPLEKS REZIDENCIAL, APART-HOTEL ME 2 STRUKTURA ME 1, 2, 3 DHE 4
KATE MBI TOKË, 2 DHE 3 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË DHËRMI,
BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Capital B” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks rezidencial, apart-hotel me 2 struktura me 1, 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë, 2 dhe 3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Dhërm, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Capital B” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA




MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR/SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 22/07/2025